

Akt themelimi

Arben Dervishi, i biri I Shaban, i datëlindjes 03.02.1980 lindur në Kuraten, Shqipëri dhe banues në Ishëm, Shkafane, Durrës

Palët janë madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët mbështetur në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, vendosën si vijon:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar për të zhvilluar veprimtari private. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga akt themelimi, Statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet "D e D WORKING SOLUTION" sh.p.k

Neni 3

Selia e shoqërisë do të jetë Rruga Vath Turja, Rashbull Sektor Rinia Zona Kadastrale 3339 nr. Pasurie 19/27 , Durrës

Neni 4

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria "D e D WORKING SOLUTION" sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga moment I rregjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së

Neni 5

Shoqëria "D e D WORKING SOLUTION" sh.p.k do të ketë si objekt veprimtarie:

Ndërmjetësim punësimi brenda dhe jashtë vendit, ndërmjetësim shkollimi brenda dhe jashtë vendit, trajnime të ndryshme, transport mallrash, bar-restorant, organizim eventesh për vete dhe të tretë.

Neni 6

Selia e shoqërisë mund të tranferohet



Neni 7

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë ne shumen 100,000 lekë i perbere nga:

- Mjete monetare 100,000 lekë, që i takon ortakut themelues si më poshtë
- **Z. Arben Dervishi**, 1 kuotë me 100 % të kapitalit, me vlerë 100,000 lekë

Fitimet që do të evidentohen pas miratimit të bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakëve pas zbritjes së taksave do të ndahen si vijon:

- Fondi rezerve
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%

Neni 8

Shoqëri mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.


Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose të huaj

Të drejtat dhe detyrat e Ortakut
Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:

Neni 10

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin
- Pjesmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.



- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortaku ka këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të veçantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria t'i njoftojë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke çeduar të drejtën e zgjedhjes.
- T'i japë shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi

Neni 11

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhja e Asamblesë mund të jetë: Asambleja e zakonshme dhe Asambleja e jashtëzakonshme

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në shoqërinë "D e D WORKING SOLUTION" sh.p.k Administrator i shoqërisë do të jetë **Arben Dervishi**, i biri I Shaban, i datëlindjes 03.02.1980 lindur në Kuraten, Shqipëri dhe banues në Ishëm, Shkafane, Durrës, i pajisur me kartë identiteti nr.038137646 i cili në të njëjtën kohë ka dhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë "D e D WORKING SOLUTION" sh.p.k. Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh financiarë me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njuh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve,



për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 12
Mbyllja e shoqërisë

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortaku, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi.

Neni 13
Kur shoqëria likujdohet:

Asambleja e ortakeve emëron likujdatorin dhe shoqëria I jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të këtij bilanci të likujdimit. Komisioni i Likujdimit përbëhet nga një ose tre anëtarë. Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në varësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet Financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakëve

në përpjestim me kuotat e vëna, pasi janë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakëve. Likujdimi i filialeve bëhet njëjloj si për shoqërinë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së filialit të likujduar dhe fondet e tij financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi të jenë bërë pagesat likujdatorëve. Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Durrës më 16/07/2022

Ortaku i vetëm i shoqërisë

Arben Dervishi



S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"D e D WORKING SOLUTIONS" SHPK

KAPITULLI I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1 Ortakët

Sot më datë 16.07.2022:

Arben Dervishi, i biri I Shaban, i datëlindjes 03.02.1980 lindur në Kuraten, Shqipëri dhe banues në Ishëm, Shkafane, Durrës, i pajisur me kartë identiteti nr.038137646.

Ortaku i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar **"D e D WORKING SOLUTIONS" shpk** hartojnë Statutin e shoqërisë konform me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare"

NENI 2 Kohezgjatja

Shoqëria **"D e D WORKING SOLUTIONS" shpk**, është një person juridik i të drejtës shqiptare që operon si e tillë nga dita e regjistrimit në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Aktiviteti i saj rregullohet konform dispozitave të këtij Statuti dhe të legjislationit shqiptar në fuqi.

Kohezgjatja e aktivitetit është për një periudhë të pacaktuar, por mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 3 Objekti i aktivitetit

Shoqëria ka për objekt të aktivitetit të saj :

Ndërmjetësim punësimi brenda dhe jashtë vendit, ndërmjetësim shkollimi brenda dhe jashtë vendit, trajnime të ndryshme, transport mallrash, bar-restorant, organizim eventesh për vete dhe të tretë.

NENI 4



Selia

Selia e shoqërisë vendoset në Rruga Vath Turja, Rashbull Sektor Rinia Zona Kadastrale 3339 nr. Pasurie 19/27 , Durrës. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të hapë filiale e zyra përfaqësie si dhe t'i mbyllë ato.

KAPITULLI II KAPITALI SHOQËROR DHE KUOTAT

NENI 5 Kapitali shoqëror

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë ne shumën 100,000 lekë i përbërë nga:

- Mjete monetare 100,000 lekë, që i takon ortakut themelues si më poshtë
- **Z. Arben Dervishi**, 1 kuotë me 100 % të kapitalit, me vlerë 100,000 lekë.

NENI 6 Kuotat

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a. kontributit ne kapital,
- b. shitblerjes,
- c. trashëgimisë
- d. dhurimit
- e. çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

Kalimi i kuotave bëhet me anë të një kontrate me shkrim.

NENI 7

Nëse një ortak ka ndërmend t'u shesë apo t'u transferojë të tretëve, tërësisht apo pjesërisht, kuotën e tij, ortakëve të tjere u rezervohet e drejta e parablerjes.

Për të lejuar ushtrimin e kësaj të drejte ortaku që dëshiron të shesë duhet të lajmërojë me letër rekomande me kthim pergjigje të gjithë ortakët, duke specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pageses dhe emrat e blerësve të mundshem.

Komunikimi i te drejtës së parablerjes duhet t'i arrijë ortakut ofrues, me letër rekomande me pergjigje, brenda 30 ditëve nga data që ortaku i interesuar për blerje ka marrë njoftimin me ofertën e shitjes.

Nëse ortaku nuk pergjigjet brenda 3 (tre) muajve nga data e komunikimit, aprovimi konsiderohet i dhene.



Nëse ortaku refuzon (me shkrim) aprovimin, brenda 3 muajve është i detyruar të blejë ose të aprovojë blerjen e kuotës në favor të blerësit të gjetur nga ortaku ofrues, me të njëjtin çmim dhe mënyrë likuidimi që ai ka specifikuar në njoftim.

NENI 8

Ndryshimet në kapital vendosen nga Asamblea e Përgjithshme me shumicë votash. Rritja e kapitalit mund të bëhet në të holla, në natyrë apo nga fitimet e pashpërndara.

Pas vendimit të asamblesë për rritjen e kapitalit, në të holla ortakët duhet të bëjnë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që secili zotëron, brenda 10 diteve.

Ortakët që kanë votuar kundra rritjes së kapitalit nuk janë të detyruar të kontribuojnë.

Pas derdhjes së kontributeve të sipërpermendur, Administratori duhet të regjistrojë rritjen e kapitalit të vazhdojë me një pershkrim të ndarjes së re të kapitalit midis ortakëve.

KAPITULLI III ASAMBLEA E PËRGJITHSHME

NENI 9

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe përfaqëson tërësinë e ortakëve.

Vendimet e saj merren konform legjislacionit në fuqi e këtij statuti dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët. Ato verbalizohen në një regjistër të veçantë siç e kërkon ligji. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 10

Asamblea e Përgjithshme vendos për:

- Politikat tregëtare,
- Ndryshimet në Statut,
- Emërimin, shpërblimin dhe shkarkimin e Administratorit, të likuidatorit apo Ekspertit Kontabël të Regjistruar,
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,



- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- Ndarjen e fitimeve të mundshme sipas nenit 76,77,78 të ligjit dhe krijimin e rezervave,
- Trasferimin dhe çedimin e kuotave,
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorit,
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë.

NENI 11

Asamblea e përgjithshme mund të mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe çdo herë që konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, por të paktën një herë në vit.

Thirrjet e Asamblese bëhen nën kujdesin e Administratorit me letër rekomande ose me postë elektronike të pakten 7 ditë të plota para mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, orën dhe vendin e mbledhjes.

NENI 12

Çdo ortak mund të përfaqësohet me një autorizim, i vlefshëm vetëm për një mbledhje, që përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite, nga një i tretë që nuk është asnjëri nga Administratores.

I takon Administratorit të konstatojë të drejtën e pjesëmarrjes.

Çdo kuotë të jep të drejtën e një vote.

Ortakët ose përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë edhe nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, audio ose audio-video konform nenit 88 të ligjit.

NENI 13

Asamblea me shumicë të kapitalit të përfaqësuar zgjedh një drejtues dhe emëron edhe një sekretar.

Vendimet e Asamblese nënshkruhen nga të gjithë ortakët prezente ose të deleguarit e tyre.

Kur ligji e parashikon, si dhe kur Administratori e konsideron të arsyeshme, verbali hartohet nga një noter.

NENI 14

Të gjitha vendimet e Asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbale të cilët ruhen nën përgjegjësinë e Administratorit.

Në procesverbalin që përmban datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrat e atij që drejton mbledhjen e të

atij që mban procesverbalin dhe rezultatet e votimit, bashkangjitet lista e pjesëmarrësve si dhe akti i thirrjes së Asamblesë së përgjithshme.

Procesverbalet e mbledhjes nënshkruhen nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

NENI 15

Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shume se 30% të kuotave të kapitalit.

Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë personalisht me shumë se 50% e ortakëve me të drejtë vote.

Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me sipër, Asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 16

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshime në statut, rritje apo zvogelim të kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e shoqërisë.

Për çështjet e tjera të parashikuara nga neni 81 i ligjit Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

NENI 17

Asambleja e përgjithshme gëzon të drejtën t'i kërkojë Gjykatës anulimin e vendimeve të administratorit kur këto shkojnë kundër legjislacionit në fuqi apo këtij statuti.

Është Asambleja që ngarkon se kush do ta përfaqësojë shoqërinë në Gjykatë.

Të drejtat e të tretëve mbeten të paprekura në të tilla raste.

KAPITULLI IV ADMINISTRIMI

NENI 18

Administrimi si dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një *Administratori*, që mund edhe të mos jetë ortak.

Administratori emërohet për një afat 5 vjecar, me të drejtë ripërteritje, me përjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Me vendim unanim të Asamblesë, detyra e Administratorit i ngarkohet



Arben Dervishi, i biri I Shaban, i datëlindjes 03.02.1980 lindur në Kuraten, Shqipëri dhe banues në Ishëm, Shkafane, Durrës, i pajisur me kartë identiteti nr.038137646 të cilit i jepet e drejta e firmës dhe e përfaqësimit të shoqërisë.

NENI 19

Administratori ka të gjithë kompetencat për realizimin e objektit të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të dhëna nga ky Statut ekskluzivisht Asamblesë së përgjithshme.

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare të vendosura nga Asambleja e përgjithshme dhe të raportojë për realizimin e tyre,
- b) të përfaqësojë shoqërinë,
- c) të kujdeset që dokumentacioni në përgjithësi dhe librat kontabël të mbahen të rregullt dhe konform normave ligjore në fuqi,
- d) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqesin Asamblesë për miratim
- e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- f) të kryejë regjistrimet e parashikuara nga ligji pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit si dhe çdo ndryshim i tyre do të paraqiten pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u regjistruar.

NENI 20

Shpërblimi i Administratorit vendoset nga Asambleja dhe duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e tij dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të Administratorit.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të Administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregëtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 21



Administratori detyrohet të :

- a. Të kryejë detyrat e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë, duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis,
- b. Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj ose ne statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara,
- c. Të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat do marrin vendim,
- ç. Të parandalojë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë,
- d. Të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit për rastet e konfliktit të interesit,
- e. Të ushtrojë detyrën e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e duhur.
- f. Të lëshojë çertifikatën e aftesisë paguese të shoqërisë, e cila konfirmon që dividendët e propozuar plotësojnë kërkesat e ligjit.

NENI 22

Administratori, gjatë detyrës së tij, përgjigjet para shoqërisë apo të tretëve që pësojnë dëme nga mosrespektimi i ligjit apo këtij Statuti.

Administratori përgjigjet personalisht, financiarisht por jo vetëm, para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij jo ligjor.

I takon Administratorit të demostrojë që ka kryer detyrën e tij në mënyrë të rregullt dhe konform normave të kërkuara.

Administratori përgjigjet para shoqërisë për vlefshmerinë e çertifikatën e aftesisë paguese të shoqërisë të lëshuar nga ai vete.

NENI 23

Administratori mund të shkarkohet me vendim të Asamblese së përgjithshme ose me vendim të Autoritetit Gjyqësor.

KAPITULLI V

VITI USHTRIMOR, BILANCI, NDARJA E FITIMIT

NENI 24

Viti ekonomik ushtrimor mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo ushtrimi do të hartohet bilanci dhe pasqyrat e tjera vjetore konform legjislacionit në fuqi.

NENI 25



Asambleja pas aprovimit të bilancit dhe pasqyrave financiare, brenda dates 30 qershor vendos mbi sjelljen me fitimin e vitit paraardhes.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, gjithnjë në proporcion me kuotat e kapitalit që secili ka në pronësi, vetëm nëse pas pagimit të dividendit :

- a. Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj,
- b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

NENI 26

Asambleja mund të vendosë shpërndarjen e fitimit neto vetëm duke filluar nga viti i dytë.

Ky fitim mund të transferohet lirisht jashtë Shqipërisë konform legjislacionit në fuqi. Për humbjet përgjigjet ekskluzivisht shoqëria me kapitalin e saj.

KAPITULLI VI PRISHJA DHE LIKUJDIMI

NENI 27

Akti Themelues, Statuti dhe aktet e tjera të shoqërisë mund të konsiderohen të pavlefshëm vetëm në rast se shkelin dispozitat e parashikuara në ligjin n. 9901 dt. 14.04.2008 " Per Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare " ose në Kodin Civil.

NENI 28

Shoqëria priset vetëm nëse :

- skadon afati i parashikuar në Aktin e Themelimit dhe në këtë Statut,
- me vendim të Asamblesë së përgjithshme,
- me hapjen e procedurave të falimentimit,
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas normave ligjore në fuqi,
- me vendim të Gjykatës.

NENI 29

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit sipas legjislacionit në fuqi.



NENI 30

Me fillimin e procedurave të likuidimit Asamblea e përgjithshme emëron likuidatorin e shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet për të përfaqësuar shoqërinë si dhe shpërblimin e tij.

Administratori paraqet prane Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuidatorit dhe dokumentat që lidhen me të.

Likuidatori depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit firmën e tij dhe në vazhdim deklaron atje çdo ndryshim të mundshëm që ka lidhje me identitetin apo kompetencat e likuidatorit.

Likuidatori zëvendëson Administratorin me të gjithë kompetencat e tij nga dita e emërimit të tij.

NENI 31

Përsa nuk specifikohet shprehimisht në këtë statut, vlejné normat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ortaku i vetëm i shoqërisë

Arben Dervishi

Arben Dervishi

[Signature]